

Ligji Nr. 02/L-57

PËR INSTITUCIONET E KULTURËS

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullatives ligjore përkitazi me veprimtarinë, aktivitetet dhe funksionimin e institucioneve të kulturës në Kosovë,

Miraton:

LIGJIN PËR INSTITUCIONET E KULTURËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Institucion i kulturës sipas këtij ligji është personi juridik i themeluar dhe i organizuar me ligj i cili merret me aktivitete, me punë dhe me veprimtari kulturore e artistike.

Institucion publik i kulturës është personi publik juridik i themeluar dhe i organizuar me ligj i cili merret me aktivitete, me punë dhe me veprimtari kulturore e artistike publike.

Institucion privat i kulturës është personi juridik jopublik i themeluar dhe i organizuar me ligj i cili merret me punë, me aktivitete dhe me veprimtari publike kulturore dhe artistike.

Dega e institucionit të kulturës është pjesë përbërëse, përkatësisht modalitet dhe nivel i organizimit, i funksionimit dhe i veprimtarisë së institucionit qendror pa cilësi të personit juridik.

Bashkësia e institucioneve të kulturës është institucion i bashkuar i dy apo më shumë institucioneve të kulturës, të cilët me pëlqimin e themeluesve bashkohen në një subjekt juridik institucional dhe ushtrojnë bashkërisht aktivitete e veprimtari të caktuara kulturore dhe artistike si një person juridik në nivel qendror ose komunal.

Veprimtaria e institucionit të kulturës është veprimtari publike kulturore e artistike, e cila përfshinë zhvillimin dhe kultivimin e vlerave të mirëfillta, kulturore e artistike.

Akti i themelimit të institucionit është akt juridik i cili përmban kushtet dhe kriteret për themelimin e institucionit dhe të drejtat e detyrimet e ndërsjella të themeluesit, përkatësisht të themeluesve.

Themeluesi i institucionit të kulturës është subjekt juridik (në cilësi të personit juridik apo fizik) i cili ka vullnet dhe interes për themelimin e institucionit publik ose privat në nivel të organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

2.1. Ligji për institucionet e kulturës është Ligj bazik sistemor dhe i rëndësisë së veçantë për kulturën. Me këtë Ligj rregullohen kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit të institucioneve të kulturës, karakteri, struktura organizative dhe menaxheriale e tyre, punët dhe veprimtaria, obligimet dhe përgjegjësitë, çështjet statusore, si dhe çështjet tjera për veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës.

2.2. Institucioni themelohet për ushtrim të veprimtarisë kulturore, shkencore dhe artistike.

Neni 3

3.1. Institucioni, konform me ligjin, pas themelimit regjistrohet tek organi kompetent.

3.2. Institucioni e humb statusin e personit juridik pas çregjistrimit.

Neni 4

Institucioni është i pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së vet në pajtim me ligjin dhe me aktin e themelimit.

Neni 5

Institucionin mund ta themelojë:

- a) Personi fizik;
- b) Personi juridik apo
- c) Personi fizik dhe juridik.

Neni 6

Konform me ligjin institucionin mund ta themelojë:

1. Kuvendi i Kosovës;
2. Qeveria e Kosovës;
3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejshëm: Ministria);
4. Komuna;
5. Personat e tjerë fizik dhe juridik po qe se kjo shprehimisht lejohet me ligj.

Neni 7

Institucionet publike të kulturës të një rëndësie të veçantë janë institucionet e themeluara në bazë të ligjeve të veçanta.

Neni 8

8.1. Themeluesi i institucionit publik ka për obligim që nga Ministria e Kulturës të kërkojë vlerësimin e përputhshmërisë së vendimit apo marrëveshjes, përkatësisht aktit për themelimin në përputhje me ligjin.

8.2. Ministria e Kulturës ka për detyrë të bëjë vendim për vlerësimin e përputhshmërisë me ligj të vendimit a marrëveshjes, përkatësisht aktit për themelimin e institucionit dhe t'ia dorëzojë themeluesit në afat prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës së rregullt.

8.3. Po qe se Ministria e Kulturës nuk e bëjë vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni dhe nuk ia dorëzon themeluesit në afatin e parashikuar, do të konsiderohet se akti i themelimit është në përputhje me ligjin.

8.4. Kundër vendimit me të cilin përcaktohet se akti për themelimin e institucionit nuk është në përputhje me ligjin themeluesi mund të iniciojë kontestin administrativ pranë gjykatës kompetente.

Neni 9

9.1. Institucioni mund të ketë një apo më shumë degë.

9.2. Dega është njësi organizative e institucionit e cila me aktin për themelimin e institucionit apo me statut të institucionit është përcaktuar që të ushtrojë një pjesë të veprimtarisë së institucionit dhe të bashkëveprojë në qarkullimin juridik.

9.3. Dega nuk është person juridik. Punën dhe veprimtarinë e vet e zhvillon konform me ligjin, me aktin mbi themelimin dhe me statutin e institucionit, ndërsa të drejtat dhe obligimet e saj i realizon përmes institucionit.

9.4. Dega e ushtron punën dhe veprimtarinë e vet nën emrin e institucionit dhe me emrin e vet, me ç'rast duhet të theksojë selinë e vet dhe selinë e institucionit.

9.5. Dega e institucionit regjistrohet në regjistrin e organit kompetent. Dokumentacionin për regjistrim të degës e parashtron institucioni.

Neni 10

10.1. Me ligj dhe me aktin përkatës të bazuar në ligj, organi kompetent i komunës Institucionit mund t'ia bartë kompetencat e veprimtarisë për të cilën është themeluar.

10.2. Institucioni ushtron autorizimet përkatëse nga paragrafi 1 i këtij neni sipas kushteve, mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me ligj.

Neni 11

Statusi juridik i të punësuarve në institucion, kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së tyre të punës në cilësinë e shërbyesve civilë si dhe çështjet e tjera lidhur me punën, rregullohen me Ligjin mbi shërbimin civil të Kosovës.

II. THEMELIMI I INSTITUCIONIT

Neni 12

12.1. Institucioni themelohet me ligj dhe me aktin për themelimin e institucionit.

12.2. Institucioni publik i kulturës themelohet nga Kuvendi, me dekret të Qeverisë, me vendim të Ministrisë dhe me vendim të komunës.

12.3. Po qe se institucionin e themelojnë dy apo më shumë komuna, aktin mbi themelimin e nxjerrin komunat e interesuara në formë të marrëveshjes me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella në pajtim me ligjin.

12.4. Personat e tjerë fizikë dhe juridikë e themelojnë institucionin me vendim, përkatësisht me marrëveshjen për themelim.

12.5. Komuna mund të themelojë institucionin e nivelit komunal.

12.6. Komunat, konform ligjit, me miratimin e Qeverisë apo të Ministrisë mund ta themelojnë institucionin e nivelit ndërkomunal.

12.7. Po qe se institucionin e themelojnë më shumë themelues, akti mbi themelimin e institucionit nxirret në formë të marrëveshjes me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të themeluesve.

12.8. Me marrëveshjen mbi themelimin, themeluesit nuk mund ta përjashtojnë apo të kufizojnë njëri-tjetrin në të drejtat dhe detyrimet e institucionit.

Neni 13

13.1. Dispozitat e aktit mbi themelimin e institucionit përmbajnë:

1. Emërtimin dhe selinë e institucionit;
2. Veprimtarinë e institucionit;
3. Organet e institucionit;
4. Mjetet të cilat i nevojiten institucionit për themelimin dhe fillimin e punës, si dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
5. Mënyrën e fitimit dhe menaxhimit të mjeteve të Institucionit;
6. Kufizimet lidhur me realizimin, ngarkimin dhe përcaktimin e patundshmërisë dhe të pasurisë tjetër të institucionit;
7. Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të themeluesve dhe të institucionit.

13.2. Po qe se institucioni themelohet me ligj, disa çështje nga paragrafi 1 i këtij neni mund të rregullohen me dekret të Qeverisë, me vendim të Ministrisë së Kulturës ose me aktin e organit tjetër publik në pajtim me ligjin.

Neni 14

Akti për themelimin e degës së institucionit nga neni 9 paragrafi 2 i këtij Ligji përmban:

1. Emërtimin dhe selinë e themeluesit;
2. Objektin e veprimtarisë së institucionit;
3. Emërtimin dhe selinë e degës;
4. Objektin dhe veprimtarinë e degës.

Neni 15

15.1. Themeluesi i institucionit e emëron ushtruesin e detyrës (UD) së drejtorit të institucionit, i cili është i autorizuar që nën mbikëqyrjen e themeluesit t'i bëjë përgatitjet për fillimin e punës së institucionit.

15.2. Themeluesi mund t'i bëjë edhe vet përgatitjet për fillimin e punës së institucionit.

III. EMËRTIMI DHE SELIA E INSTITUCIONIT

Neni 16

Institucioni ka emërtimin me të cilin ushtron veprimtarinë e vet dhe që vepron e bashkëvepron në qarkullimin juridik.

Neni 17

17.1. Emërtimi i institucionit identifikohet me veprimtarinë e tij.

17.2. Emërtimi i institucionit duhet të dallohet në mënyrë të qartë nga emërtimi i institucionit tjetër, ndërsa me përmbajtjen e vet nuk guxon të krijojë huti lidhur me veprimtarinë, identifikimin me institucionin tjetër, me personin tjetër fizik apo juridik.

17.3. Përjashtimisht nga dispozita e paragrafit 2 të këtij neni, institucioni i cili është në bashkësinë e institucioneve nga neni 62 i këtij Ligji mund të përdorë në emërtimin e vet emrin e asaj bashkësie.

Neni 18

18.1. Nocioni institucion qendror dhe atributet e tij, pastaj shenjat e tjera identifikuese, përfshirë edhe imitimin e tyre, mund të futen në emërtimin e institucionit vetëm me ligj ose me leje të Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë apo të organit tjetër publik të autorizuar.

18.2. Emërtimi i institucionit të nivelit komunal dhe atributet e tij, pastaj shenjat identifikuese të tij, përfshirë edhe imitimin e tyre, mund të vihen në emërtimin e institucionit vetëm me lejen e organit kompetent të komunës.

18.3. Emërtimi i institucionit mund të mbajë emërtimin e shtetit tjetër apo të organizatës ndërkombëtare (ndërshtetërore), stemën e tij, flamurin apo emblemën tjetër vetëm në bazë të lejes së Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë dhe pëlqimit paraprakisht të siguruar nga shteti i huaj, përkatësisht nga organizata ndërkombëtare (ndërshtetërore).

Neni 19

19.1. Institucioni mund të emërtohet me emrin e ndonjë personi të merituar me pëlqimin e tij, e po qe se personi ka vdekur, atëherë me pëlqimin e trashëgimtarëve të tij.

19.2. Institucioni mund të emërtohet me emrin e ndonjë personi të rëndësisë historike, kulturore apo shkencore vetëm me pëlqimin e trashëgimtarëve dhe nëse shfrytëzohet në mënyrën me të cilën nuk cenohet dinjiteti i atij personi.

Neni 20

20.1. Institucioni mund të përdorë edhe emërtimin e shkurtuar (akronimin).

20.2. Emërtimi i shkurtuar duhet të përmbajë pjesën karakteristike të institucionit.

20.3. Emërtimi i shkurtuar regjistrohet në regjistrin e organit kompetent.

Neni 21

21.1. Emërtimi i institucionit duhet të jetë i shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera zyrtare në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

21.2. Emërtimi i institucionit në gjuhë të huaja ose në gjuhë të vdekur bëhet me leje të Ministrisë.

21.3. Në korrespondencë me personat fizikë dhe juridikë jashtë vendit, institucioni, krahas emërimit që është regjistruar në regjistrin e organit kompetent, mund të përdorë edhe përkthimin e emërimit në gjuhën e huaj apo në gjuhën e vdekur.

21.4. Dispozitat e paragrafit 1 deri në 3 të këtij neni aplikohen edhe në emërtimin e shkurtuar të institucionit.

Neni 22

Institucioni është i detyruar të përdorë emërtimin e plotë dhe emërtimin e shkurtuar në formën dhe përmbajtjen me të cilën është regjistruar në regjistrin e organit kompetent.

Neni 23

Emërtimi i institucionit duhet të vendoset në ndërtesën ku është selia e tij, përkatësisht aty ku institucioni e ushtron veprimtarinë për të cilën është themeluar.

Neni 24

Emërtimi i institucionit mbrohet me ligj.

Neni 25

25.1. Selia e institucionit është vendi ku e ushtron institucioni veprimtarinë e vet.

25.2. Po qe se institucioni e ushtron veprimtarinë në më shumë vende, selia e institucionit është vendi ku është i vendosur organi drejtues.

25.3. Selia e institucionit nuk mund të jetë jashtë territorit të Kosovës.

Neni 26

26.1. Institucioni mund ta ndërrojë emërtimin dhe selinë vetëm me vendim të themeluesit të institucionit.

26.2. Ndërrimi i selisë së institucionit regjistrohet në regjistrin e organit kompetent.

Neni 27

Në emërtimin dhe selinë e degës së institucionit aplikohen në mënyrë adekuate dispozitat e këtij ligji mbi emërtimin dhe selinë e institucionit.

IV. VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT

Neni 28

28.1. Veprimtaria e institucionit përcaktohet me aktin për themelim të bazuar në ligj.

28.2. Institucioni mund ta ndërrojë apo mund ta zgjerojë veprimtarinë e tij. Vendimin për ndërrimin apo zgjerimin e veprimtarisë e bie këshilli drejtues i institucionit me pëlqimin paraprak të themeluesit po qe se me ligj apo me aktin mbi themelim nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 29

29.1. Veprimtaria e institucionit regjistrohet në regjistrin e organit kompetent.

29.2. Krahas veprimtarisë kryesore, institucioni mund të ushtrojë edhe veprimtari të tjera të cilat përkojnë me aktivitetin e gjithëmbarshtëm të tij.

Neni 30

Institucioni ushtron veprimtarinë e vet vetëm pasi që të jetë regjistruar dhe pasi që të jetë siguruar vendimi përfundimtar për fillimin e punës me të cilin konfirmohet se janë plotësuar kushtet teknike, shëndetësore, ekologjike, kadrovike, buxhetore dhe kushtet e tjera të parapara për ushtrimin e asaj veprimtarie.

Neni 31

31.1. Veprimtaria e degës së institucionit përcaktohet në kuadër të veprimtarisë së institucionit me aktin për themelimin e tij dhe me statut. Veprimtaria e degës së institucionit regjistrohet në regjistrin e organit kompetent.

31.2. Në veprimtarinë e degës së institucionit aplikohen në mënyrë përkatëse dispozitat e këtij ligji mbi veprimtarinë e institucionit.

V. ORGANIZIMI DHE ORGANET E INSTITUCIONIT

Organizimi i institucionit

Neni 32

Organizimi i brendshëm i institucionit rregullohet me statut të institucionit të bazuar në ligj dhe në aktin për themelim.

Neni 33

Organet e institucionit janë:

- Drejtori;
- Këshilli drejtues;
- Këshilli profesional, përkatësisht artistik

Drejtori

Neni 34

34.1. Drejtori është udhëheqës i institucionit dhe organ ekzekutiv i tij.

34.2. Drejtori organizon dhe udhëheq punën dhe veprimtarinë e institucionit, prezanton dhe e përfaqëson institucionin, ndërmerr të gjitha veprimet juridike në emër dhe për llogari të institucionit, e përfaqëson institucionin në gjykata dhe në organe të tjera të administratës publike.

34.3. Drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së institucionit.

34.4. Drejtori, pa autorizim të veçantë të këshillit drejtues apo të themeluesit të institucionit, përkatësisht të organit të cilin e ka caktuar themeluesi, nuk mund të paraqitet si palë e dytë kontraktuese dhe të lidhë kontrata me institucionin në emër të vet dhe për llogari të vet, në emër të vet dhe për llogari të personave të tjerë apo në emër të tjerëve dhe për llogari të personave të tjerë.

34.5. Drejtori i institucionit mund ta autorizojë personin tjetër për ta përfaqësuar institucionin në qarkullimin juridik. Autorizimin mund ta jep vetëm brenda suazave të kompetencave të tij.

34.6. Derisa Institucioni të themelohet përkatësisht konsolidohet, ose në ndonjë situatë tjetër juridike, drejtori i ka të gjitha të drejtat nga neni 38 dhe 39 i këtij Ligji, përveç nëse me ligj është rregulluar ndryshe.

34.7. Situata juridike nga paragrafi paraprak mund të zgjatë më së shumti tre muaj.

34.8. Drejtori udhëheq punën e gjithëmbarshme dhe organizative të institucionit dhe është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit.

Neni 35

35.1. Drejtorin e emëron dhe e shkarkon këshilli drejtues po qe se me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

35.2. Me ligj ose me aktin për themelim mund të përcaktohet që drejtorin e institucionit publik ta emërojë Qeveria, Ministria ose organi i nivelit komunal.

Neni 36

36.1. Drejtor i institucionit mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj, me aktin e themelimit dhe me statutin e institucionit.

36.2. Mandati i drejtorit është katër vjet po qe se me aktin për themelim apo me statut të institucionit nuk është përcaktuar ndryshe. Personi i njëjtë mund të rizgjidhet.

36.3. Të drejtat, detyrat dhe kompetencat e drejtorit përcaktohen më hollësisht me aktin nënligjor të institucionit.

36.4. Kushtet për zgjedhjen dhe emërimin e drejtorit zbatohen në përputhje me ligjin, me aktin për themelim dhe me statutin e institucionit.

Neni 37

Drejtori i institucionit emërohet në bazë të konkursit publik.

Këshilli drejtues

Neni 38

38.1. Institucioni ka këshillin drejtues si organ kolegjal punë drejtues (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli drejtues) po qe se me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

38.2. Përbërja, mënyra e emërimit, zgjedhja e anëtarëve, kohëzgjatja e mandatit për këshillin drejtues si dhe mënyra e marrjes së vendimeve përcaktohen me ligj, me aktin mbi themelimin dhe me statut të institucionit.

Neni 39

Këshilli drejtues nxjerr dhe miraton programin e punës, harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, aprovon dhe miraton buxhetin vjetor dhe mbikëqyr realizimin e tyre, i propozon themeluesit ndërrimin e veprimtarisë apo zgjerimin e saj, nxjerr vendime e akte të tjera në çështjet e caktuara dhe me interes për institucionin dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj, me aktin mbi themelimin dhe me statut të institucionit.

Këshilli profesional, përkatësisht artistik

Neni 40

40.1. Institucioni ka këshillin profesional, përkatësisht artistik si organ kolegjal.

40.2. Përbërja, themelimi dhe punët e këshillit profesional, përkatësisht artistik të institucionit përcaktohen më hollësisht me statut të institucionit, në pajtim me ligjin dhe aktin për themelim.

Neni 41

Këshilli profesional, përkatësisht artistik shqyrton dhe vendos për çështjet profesionale, respektivisht artistike të punës së institucionit në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj, me aktin e themelimit dhe me statutin e institucionit.

Udhëheqësi profesional, përkatësisht artistik

Neni 42

42.1. Institucioni mund të ketë udhëheqësin profesional, përkatësisht artistik. Kushtet, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e udhëheqësit profesional, përkatësisht artistik përcaktohen me hollësisht me statut, në pajtim me ligjin dhe me aktin e themelimit.

42.2. Udhëheqësin profesional, përkatësisht artistik e zgjedh këshilli drejtues i institucionit në bazë të konkursit publik.

Organet e tjera të institucionit

Neni 43

43.1. Brenda institucionit sipas nevojës dhe në interes të funksionimit të institucionit mund të ketë edhe trupa punues e komisione profesionale e këshillëdhënëse.

43.2. Përbërja, mënyra e themelimit, fushëveprimi dhe kompetencat e këtyre organeve përcaktohen me statut të institucionit në pajtim me ligjin dhe aktin mbi themelimin e institucionit.

Organet e degës së institucionit

Neni 44

Dega e institucionit ka këto organe:

- a) Drejtuesin e institucionit;
- b) Këshillin profesional, përkatësisht artistik.

Neni 45

45.1. Drejtuesi i degës së institucionit, në suaza të të drejtave dhe detyrimeve të degës të përcaktuara me aktin e themelimit dhe me statut, e organizon dhe e udhëheq punën dhe veprimtarinë e degës së institucionit.

45.2. Dega e institucionit mund të ketë edhe organe të tjera në pajtim me nenin paraprak.

45.3. Dega e institucionit për punën dhe për veprimtarinë e vet bashkëpunon dhe informon institucionin kompetent komunal dhe qendror.

VI. AKTET E PËRGJITHSHME TË INSTITUCIONIT

Neni 46

Aktet e përgjithshme të institucionit janë statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme.

Neni 47

Me statutin e institucionit përcaktohet organizimi, funksionimi, autorizimet dhe mënyra e vendosjes së organeve, si dhe rregullohen çështjet e tjera me rëndësi për ushtrimin e veprimtarisë së Institucionit.

Neni 48

Statutin e institucionit e nxjerr këshilli drejtues, ndërsa e miraton themeluesi. Aktet e tjera të përgjithshme i nxjerr këshilli drejtues po qe se me ligj apo me statut të institucionit nuk është paraparë ndryshe.

Neni 49

49.1. Statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga organi kompetent i institucionit, përkatësisht ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

49.2. Statuti dhe aktet e përgjithshme të institucionit nuk mund kenë veprim retroaktiv.

Neni 50

Personeli përgjegjës dhe i autorizuar i institucionit apo shërbimi përkatës i tij ka për obligim që dispozitat e aktit mbi themelimin, të statutit dhe të akteve të tjera të përgjithshme t'ua bëjë në mënyrë të përshtatshme dhe të arritshme opinionit.

VII. PASURIA E INSTITUCIONIT DHE PËRGJEGJËSIA

PËR DETYRIMET E TIJ

Neni 51

51.1. Pasuria e institucionit është pasuria e luajtshme dhe (ose) e paluajtshme të cilën e ka krijuar institucioni.

51.2. Mjetet për punë të siguruara nga themeluesi, ato të realizuara nga ofrimi i shërbimeve si dhe nga burimet e tjera paraqesin pasurinë e institucionit.

51.3. Po qe se në ushtrimin e veprimtarisë së vet institucioni realizon fitim, ai fitim përdoret për ushtrimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së institucionit në pajtim me ligjin, përkatësisht aktin për themelimin dhe me statutin e institucionit.

Neni 52

Institucioni, pa pëlqimin e themeluesit të institucionit, përkatësisht të organit të cilin e cakton ai, nuk mund të fitojë, të ngarkojë apo të tjetërsojë pasurinë e paluajjtshme dhe pasurinë tjetër vlera e së cilës është më e madhe se vlera e përcaktuar me aktin për themelimin apo me statutin e institucionit.

Neni 53

53.1. Institucioni përgjigjet për obligimet e tij me tërë pasurinë e vet.

53.2. Themeluesi i institucionit në mënyrë solidare dhe të pakufizuar përgjigjet për obligimet e tij.

VIII. PUNA DHE VEPRIMTARIA PUBLIKE E INSTITUCIONIT

Neni 54

54.1. Veprimtaria dhe puna e institucionit është publike.

54.2. Në bazë të ligjit, në mënyrën e përcaktuar me statut të institucionit dhe aktin mbi themelimin, personeli i autorizuar dhe shërbimi përkatës i institucionit është i obliguar që me kohë

dhe në mënyrë të saktë ta njoftojë opinionin për ushtrimin e veprimtarisë apo të pjesës së veprimtarisë për të cilën është themeluar.

Neni 55

55.1. Personeli i autorizuar apo shërbimi përkatës i institucionit është i obliguar që qytetarët, personat juridikë dhe shfrytëzuesit e tjerë t'i njoftojë me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për kushtet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve të veta dhe ushtrimin e punëve nga veprimtaria për të cilën është themeluar institucioni.

55.2. Personeli i autorizuar apo shërbimi përkatës i institucionit në bazë të ligjit është i obliguar t'i respektojë afatet ligjore apo që në një afat tjetër të përshtatshëm ta njoftojë çdo qytetar, person tjetër juridik dhe shfrytëzuesit tjetër, me kërkesë të tyre dhe t'i informojë për kushtet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve të veta, si dhe për ushtrimin e punëve nga veprimtaria për të cilën është themeluar.

55.3. Personeli i autorizuar apo shërbimi përkatës i institucionit është i obliguar që në afatin ligjor, mjeteve të informimit publik t'u ofrojë informacionet për ushtrimin e veprimtarisë së vet dhe t'ua mundësojë qasjen në dokumentacionin përkatës, me kërkesë të tyre.

55.4. Personeli i autorizuar apo shërbimi përkatës i institucionit do të ndalojë dhënien e informacioneve, përkatësisht qasjen në dokumentacion po që se me ligj, me aktin për themelimin e institucionit apo me statut të institucionit është përcaktuar si fshehtësi zyrtare, afariste, shkencore ose artistike, si dhe kur ka të bëjë me të dhënat personale të personave fizikë.

Neni 56

Kur Institucioni mban këshillime dhe tubime kulturore, shkencore, profesionale dhe të tjera, për çështjet për të cilat është i interesuar opinionin, ka për detyrë që mjetet e informimit publik t'i njoftojë për këtë dhe t'ua mundësojë praninë e tyre.

IX. MBIKËQYRJA E PUNËS SË INSTITUCIONIT

Neni 57

57.1. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës, veprimtarisë dhe të akteve të përgjithshme, si dhe zbatueshmërinë e tyre e ushtron themeluesi, përkatësisht Ministria, po qe se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

57.2. Mbikëqyrjen e akteve të përgjithshme, si dhe punëve të tjera, institucioni publik i ushtron në bazë të autorizimit publik në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet sistemi i administratës publike.

Neni 58

58.1. Po qe se me ligjin me të cilin rregullohet ushtrimi i veprimtarisë së caktuar nuk është përcaktuar ndryshe, drejtori i institucionit është i obliguar që në afat prej tetë ditësh nga dita e nxjerrjes t'ia dërgojë statutin organit kompetent nga neni 60 i këtij ligji.

58.2. Po qe se organi kompetent nga neni 60 i këtij ligji konsideron që statuti apo akti i përgjithshëm është në kundërshtim me ligjin apo me dispozita të tjera ligjore, do ta ndalojë zbatimin dhe në afat prej 30 ditësh do t'i propozojë Ministrisë ose Qeverisë që aktin kontestues ta anulojë, abrogojë apo ta ndryshojë.

58.3. Kundër vendimit të Ministrisë ose të Qeverisë me të cilin anulohet apo abrogohet statuti ose akti i përgjithshëm institucioni ka të drejtë të iniciojë kontestin administrativ pranë gjykatës kompetente.

Neni 59

Mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së institucionit e ushtron themeluesi, përkatësisht Ministria e Kulturës po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Neni 60

60.1. Mbikëqyrjen e punës profesionale të institucionit e ushtron organi profesional i përcaktuar me ligj.

60.2. Organi nga paragrafi 1 i këtij neni ka për detyrë që institucionit t'i ofrojë ndihmë profesionale dhe në pajtim me ligjin dhe dispozitat e tjera nënligjore t'i jep udhëzime profesionale për ushtrimin e veprimtarisë si dhe të ndërmerr masa për parandalimin apo evitimin e gabimeve në punën profesionale.

X. NDRYSHIMET STATUSORE

Neni 61

61.1. Institucioni mund t'i bashkëngjitet institucionit tjetër ose dy a më shumë institucione mund të bashkohen në një institucion, ose një institucion mund të ndahet në dy a më shumë institucione.

61.2. Vendimin për ndërrimet statusore nga paragrafi 1 i këtij neni e merr themeluesi i institucionit.

61.3. Ndërrimet statusore nga paragrafi 1 i këtij neni ndërmerren dhe zbatohen në bazë të ligjit.

XI. BASHKIMI I INSTITUCIONEVE

Neni 62

62.1. Institucionet, me pëlqimin e themeluesit, mund të bashkohen në bashkësi të institucioneve.

62.2. Bashkësia e institucioneve është person juridik dhe regjistrohet në regjistrin e organit kompetent. Lidhur me emërtimin, selinë, veprimtarinë dhe organizimin e bashkësisë së institucioneve aplikohen në mënyrë përkatëse dispozitat e këtij ligji mbi emërtimin, selinë, veprimtarinë dhe organizimin e institucioneve.

XII. FINANCIMI I INSTITUCIONEVE

Neni 63

63.1. Aktivitetet, puna dhe veprimtaria e institucioneve publike të kulturës së Kosovës, themelues apo bashkëthemelues i të cilëve është Kuvendi i Kosovës, Qeveria ose Ministria financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

63.2. Institucionet private të kulturës në aktivitetet dhe veprimtarinë e tyre mund të përkrahen financiarisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

XIII. NDËRPRERJA DHE SHUARJA E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT

Neni 64

Veprimtaria e Institucionit ndërpritet përkatësisht pushon së vepruari:

1. Me vendim të plotfuqishëm të gjykatës me të cilin është përcaktuar nuliteti i regjistrimit të institucionit në organin kompetent;
2. Me vendim të plotfuqishëm të gjykatës mbi ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është themeluar;
3. Me vendim të themeluesit;
4. Në rastin e bashkëngjitjes me institucionin tjetër, të fuzionimit, të ndarjes në dy a më shumë institucione, si dhe me shndërrimin në asociacion tjetër;
5. Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për shuarjen e institucionit dhe
6. Në rastet e tjera të përcaktuara me ligj ose me aktin e themelimit.

Neni 65

Dega e institucionit pushon së vepruari:

- a. nëse institucioni bie vendim mbi ndërprerjen e degës;
- b. nëse institucioni pushon së ekzistuari.

XIV. REGJISTRIMI I INSTITUCIONIT

Neni 66

Institucioni, dega e institucionit dhe bashkësia e institucioneve regjistrohen në regjistrin përkatës të organit kompetent.

Neni 67

67.1. Institucioni, njësitë e institucionit dhe bashkësitë e institucioneve regjistrohen edhe në regjistër, përkatësisht në evidencën tjetër përkatëse të cilën e mban Ministria e Kulturës.

67.2. Ministria e Kulturës lidhur me regjistrimin e institucionit themelon regjistër qendror të institucioneve të kulturës.

67.3. Akreditimi i Institucionit si dhe forma dhe përmbajtja e regjistrit, përkatësisht evidencës së tij, rregullohen me aktin nënligjor të nxjerr nga Ministri i Kulturës.

Neni 68

68.1. Institucioni është i pavarur në qarkullimin juridik.

68.2. Institucioni ka xhirollogarinë e mëvetësishme në njërën nga bankat e licencuara të Kosovës.

XV. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 69

69.1. Po qe se me ligj me të cilin rregullohet ushtrimi i veprimtarisë nga neni 2, paragrafi 2 i këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe, institucioni do të ndëshkohet për shkelje administrative:

1. Nëse nuk e paraqet regjistrimin e degës së institucionit në regjistrin e organit kompetent (neni 9, paragrafi 5);
2. Nëse në ushtrimin e veprimtarisë nuk e përdor emërtimin ashtu siç është regjistruar në regjistrin e organit kompetent (neni 22);
3. Nëse ushtron veprimtarinë para se të jetë regjistruar në regjistrin e organit kompetent apo para se të ketë marrë vendimin përfundimtar me të cilin përcaktohet se janë përmbushur kushtet teknike, shëndetësore, ekologjike dhe të tjera të parashikuara për ushtrimin e asaj veprimtarie (neni 30);
4. Nëse me rastin e zgjedhjes apo të shkarkimit të drejtorit nuk vepron në përputhje me dispozitat e neneve 35 deri te neni 37 i këtij ligji;
5. Nëse nuk i mundëson opinionit qasje në dispozitat e aktit për themelimin, të statutit apo të aktit tjetër të përgjithshëm me të cilat rregullohet ushtrimi i veprimtarisë apo i pjesës së veprimtarisë që konsiderohet shërbim publik (neni 50);
6. Nëse fitimin nuk e përdor sipas mënyrës së paraparë me dispozitën e nenit 51, paragrafi 3 i këtij ligji;
7. Nëse organit kompetent nuk ia dorëzon brenda afatit statutin apo aktin e përgjithshëm me të cilin rregullohet ushtrimi i veprimtarisë publike të kulturës (neni 58, paragrafi 1).

69.2. Për shkelje administrative nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet dënimi me gjobë prej 500 deri 1.000 euro.

69.3. Për shkelje administrative nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe drejtori i institucionit, përkatësisht personi tjetër që sipas dispozitave të këtij ligji, të aktit mbi themelimin e institucionit apo të statutit të institucionit është përgjegjës lidhur me veprimin me të cilin është bërë kundërvajtja për çka gjobitet prej 200 deri 500 euro.

69.4. Nëse institucioni është dënuar për shkelje administrative nga paragrafi 1 pika, 6 e këtij neni shqiptohet detyrimisht edhe masa mbrojtëse e marrjes së përfitimit pasuror.

69.5. Të gjitha mjetet financiare që realizohen nga shqiptimi i dënimeve derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

XVI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 70

70.1. Deri me konstituimin e Këshillit drejtues të institucionit në pajtim me dispozitat e këtij ligji, punët e drejtorit, përkatësisht të qeverisjes së institucionit do t'i vazhdojë t'i ushtrojë personi i cili kryen punën e udhëheqjes së institucionit ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

70.2. Në rast të ngecjes, bllokimit ose pengimit të punës së institucionit për shkaqe subjektive, Qeveria, përkatësisht Ministria, personin nga paragrafi 1 i këtij neni mund ta shkarkojë dhe në detyrën e tij ta emërojë personin tjetër derisa të zgjedhën, përkatësisht të emërohen organet e reja të institucionit në përputhje me këtë ligj. Këtë të drejtë e kanë edhe komunat për institucionet e kulturës që i themelojnë ato.

Neni 71

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

18.08.2006

UNMIK/REG/ 2006/44